



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 04, Datë 22.01.2024

MBI

**KËRKESËN PËR SHTYRJE TË AFATIT TË DEROGIMIT TË SHOQËRISË KALISI
HYDROPOWER SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, “Kodit të Transmetimit”, miratuar me vendimin e bordit të Entit rregullator të Energjisë (ERE) nr. 63, datë 11.04.2022; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 22.01.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 174 prot., datë 17.01.2024 të përgatitur nga Drejtoritë Teknike për “Mbi shqyrtimin e kërkesës për shtyrje të afatit të derogimit të shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k”,

Konstatohet se:

- ERE me vendimin nr. 140, datë 15.06.2021, ndër të tjera vendosi: (1) *Të miratojë derogimin e kërkuar nga shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k., si vijon:*
 - a) *Objekti i derogimit: Realizimi i traktit 110 kV të linjës dhe të transformatorit ngritës që parashikohet të instalohet në Nënstacionin 110/20/6.3 kV pranë HEC Veleshnica 1 në dy faza implementimi. Në fazën e parë parashikohet që trakti 110 kV të jetë i pajisur me thikë ndarëse për një periudhë 24 mujore dhe pas kësaj periudhe të pajiset me të gjithë elementët e nevojshëm thikë dhe çelës.*
 - b) *Derogimin/pezullimin e përkohshëm të pikës 3 (b) të nenit 35 të Kodit të Transmetimit. Kjo pikë vetëm për këtë rast do të jetë në zbatim të shkallëzuar me dy faza. Faza e parë për një afat 24 mujor trakti 110 kV të jetë i pajisur me thikë ndarëse dhe në përfundim të këtij afati trakti 110 kV të pajiset me të gjithë elementët e nevojshëm thikë dhe çelës.*
 - c) *Afati i derogimit për një periudhë 24 muaj.*
- Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k., është e paisur me Licencën për prodhimin e energjisë elektrike Seria P 20, dhe numër Licence 465, dhe ka bërë me dije se se: Shoqëria ka aplikuar pranë OST sh.a. për lidhjen me rrjetin e transmetimit 110 kV, nëpërmjet shkresës nr. 532 prot., datë 18.01 2019. Në zbatim të marrëveshjes së lidhjes HEC “Veleshnica 1&2” me fuqi të instaluar 13.9 MW, do të lidhet me rrjetin e transmetimit nëpërmjet një nënstacioni 110/20/6.3 kV, pranë HEC “Veleshnica 1”, me fuqi transformatori 20MVA, dhe një linje elektrike ajrore

110 kV me dy qarqe rreth 250, metër të gjatë dhe me përcjellës ACSR-240 mm², duke çarë linjën 110 kV Peshkopi – Lapaj. Lidhja e HEC “Veleshnica 2” do të realizohet nëpërmjet N/ST 20/6.3 MVA, pranë HEC-it me një linje 20 kV rreth 3.2 km të gjatë, për t’u lidhur me zbarat 20 kV të Nën/Stacionit 110/20 kV pranë HEC “Veleshnica 1”.

- Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k., nëpërmjet shkresës së protokolluar në ERE me nr. 2245/5 prot., datë 30.11.2023, në të cilën ka parashtruar kërkesën për shtyrje të afatit të derogimit, për ndërtimin e trakteve të linjës në n/stacionin hec “Veleshica” ndër të tjera parashtron si më poshtë vijon:
 - (a) *Koncesionari "Kalisi Hydropower" sh.p.k. ka marrë nga MIE shtyrje afati të kontratës koncesionare pasi ka përfunduar ndërtimin e hec “Veleshnica 1” i cili është lidhur dhe me skemën e sistemit transmetimit me OST sh.a. vazhdon ndërtimin për hec “Veleshnica 2” dhe duke patur parasysh problematikat e hasura gjatë punimeve të zbatimit:*
 - (b) *Pengim nga banorët e zonës dhe marrëveshjet e kryera me banorët e zonës për investimin në ndërtimin e rrugëve, urave dhe kanaleve vaditës të fshatrave, Kalle, Vlesh, Shulla, Kalis dhe Zall-Kalis, Pandemia Covid 19 (e cila na penalizoi në punimet ndërtimore për shkak të fuqisë punëtore dhe rritje të çmimeve të materialeve të ndërtimit), Problemet gjeologjike gjatë zbatimit të punimeve, Kushtet atmosferike gjatë stinës së dimrit. Vonesat që ka pasur sipërmarrësi nga prodhuesit e jashtëm për prodhimin e pajisjeve me elementet e nevojshme etj.*
 - (c) *Shoqëria ka nënshkruar kontratë me nënkotaktor "EL-POWER" sh.p.k., për "Ndërtimi i trakteve të linjës në n/stacionin hec veleshica si dhe pajisjen e tyre me elemente të nevojshme", me objekt Furnizim, instalim, komisionim, testim dhe energjizim i pajisjeve të Nstacionit 110 kV HEC VELESHICA (Trakti i linjës 110 kV LAPAJ dhe PESHKOPI)...*
 - (d) *Duke qënë se në muajt e dimrit dhe të pranverës hidrocentrali është në prodhim, kërkon që punimet për Ndërtimin e trakteve të linjës në n/stacionin për hec “Veleshnica 2” të bëhen në muajt e verës kur nuk ka prodhim të energjisë elektrike, pasi ky element do të ndikojë negativisht në bilancin e prodhimit të energjisë elektrike. Si dhe në periudhë dimri për shkak të kushteve atmosferikes është e pa mundur që të bëhen punimet në terren në nënstacion.*
- Këshilli i Ministrave nisur nga situata e krijuar në tregjet e Energjisë elektrike të cilat çuan në rritje të mëdha të çmimit të Energjisë elektrike nëpërmjet Vendimit nr. 584, datë 8.10.2021, vendosi për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike deri më 15 prill 2022. Gjithashtu, Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 650, datë 10.10.2022, vendosi detyrimin e shërbimit publik për Prodhuesit me Përparësi të cilët kanë kontratë me FTL sh.a., si dhe shtyrjen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike deri në 30 qershor 2023. Ndërsa me VKM-në nr. 449, datë 26.07.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 584, datë 08.10.2021 “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike” e ndryshuar, e shtyu gjendjen e emergjencës së furnizimit me energji elektrike deri më 31 dhjetor 2023.
- Shoqëria “Kalisi Hydropower”sh.p.k. shprehet se dhe rritja e çmimeve të energjisë elektrike duke marrë në konsideratë ndikimin e kësaj të fundit në proceset e industrisë u shoqërua me një rritje çmimesh në shumë produkte ku nuk përjashtohen dhe paisjet për sistemet

teknologjike që mund të ketë sjellë vonesat e përmendura nga shoqëria në prodhimin dhe furnizimin e pajisjeve nga furnizuesit e jashtëm.

- Derogimi i dhënë nga ERE me vendimin me vendimin nr. 140, datë 15.06.2021, të shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k., që nga dalja e VKM nr. 584, datë 8.10.2021 deri ne 31.12.2023, është aplikuar në kushtet e gjendjes së emergjencës së furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve, të shpallur nga Këshilli i Ministrave.
- Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k., nëpërmjet shkresës së protokolluar në ERE me nr. 2245/5 prot., datë 30.11.2023, ka parashtruar kërkesën për shtyrje te afatit të derogimit të miratuar nga ERE me vendimin nr.140, datë 15.06.2021 prej një periudhe 24 muaj e cila do të mundësonte realizimin e punimeve objekt kontrate dhe trakti 110 kV të jetë i pajisur me të gjithë elementët e nevojshëm, thikë dhe çelës.
- Në pikën 1, gërma (c), të vendimit të ERE-s nr. 140/2021 është parashikuar: “Afati i derogimit është për një periudhë 24 muaj”, duke qënë se vendimi është parashikuar të hyjë në fuqi menjëherë periudha 24 mujore fillon në datën 15.06.2021 afati i tij ka përfunduar ne 15.06.2023.
- Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k., nuk ka kërkuar ndryshimin e objektit të derogimit, por vetëm zgjatjen e efekteve juridike të këtij derogimi, pa ndryshuar asnjë element të tij. Në këto rrethana duke qënë se jemi duke vlerësuar të njëjtin objekt derogimi të pa ndryshuar vlerësimet përkatëse ato që lidhen me vendimin e ERE-s nr. 85, datë 12.05.2020, për miratimin e “Kritereve për të vendosur derogime për modulet gjeneruese të energjisë elektrike”, të “Kodit të Rrjetit mbi Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin e Gjeneruesve” transpozim i Rregullores së KE-së 2016/631, miratuar anë vendimin e bordit të ERE-s nr.129 datë 04. 06. 2018, të cilat janë vlerësuar në mënyrë shteruese në procesin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s nr. 140, datë 15.06.2021. Gjithashtu në këtë proces është marrë dhe në konsideratë sa parashtruar nga OST sh.a. me shkresën nr. 3465/1 prot., datë 09.06.2021.
- Në të njëjtën kohë bëjmë me dije se ne komunikimet e sipërcituara (respektivisht shkresat nr. 2245 prot. datë 06.10.2023, si dhe nr. 2245/2 prot. datë 24.10.2023, e ne vijim) te ERE, OST sh.a. ka qënë pjesë e këtyre komunikimeve dhe nuk ka shprehur asnjë problematikë lidhur me këtë derogim. Edhe përgjatë periudhës së zbatimit të këtij derogimi nuk kemi problematikë të paraqitur nga OST sh.a.
- Bordi i ERE-s me vendim nr. 63, datë 11.04.2022, ka miratuar Kodin e ri të Transmetimi, i cili është në zbatim prej datës 1 Korrik 2022. Nëpërmjet këtij vendimi prej datës 1 Korrik 2022 është shfuqizuar Kodi i Transmetimit miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, i ndryshuar.
- Në nenin 40 pika (3) gërma (b) e Kodit të Transmetimit miratuar me vendim nr. 63, datë 11.04.2022, përcakton se: *“Lidhjet ndërmjet instalimeve të përdoruesit dhe sistemit të transmetimit duhet të realizohen nëpërmjet çelësave të fuqisë të aftë për t’u shkyçur me veprim të shpejtë, sipas kërkesave dhe standardeve në aktet e sipërpërmendura.”*
- Për shkak të shfuqizimit të “Kodit të Transmetimit” të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, i ndryshuar dhe hyrjen në fuqi të “Kodit të Transmetimit” miratuar me vendimin nr. 63, datë 11.04.2022, duhet të saktësohet pika 1 gërma (b) e parashikuar në

- vendimin e ERE-s nr. 140, datë 15.06.2021. Derrogimin/pezullimin e përkohshëm të pikës 3 gërma (b) të nenit 40 të Kodit të Transmetimit miratuar me vendim nr. 63, datë 11.04.2022.
- Ndër të tjera, shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k., shprehet se: *Duke qënë se jemi në periudhë dimri për shkak të kushteve atmosferikes është e pa mundur që të bëhen punimet në terren në nënstacion, për ndërtimin e traktit të linjës në n/stacionin duhet të bëhet edhe ndërprerja e prodhimit të energjisë elektrike të hidrocentralit, e cila do të ndikojë negativisht në bilancin e prodhimit të energjisë elektrike.*
 - Në muajt e dimrit dhe të pranverës hidrocentrali është në prodhim dhe shoqëria kërkon që punimet për ndërtimin e trakteve të linjës në n/stacionin të bëhen në muajt e verës kur nuk ka prodhim të energjisë elektrike.
 - Sikurse evidentohet, kërkohet që të eliminohet ndërprerja e prodhimit të energjisë elektrike e cila sjell pasoja negative në bilancin energjistik, por edhe pamundësia e realizimit të punimeve në terren në muajt e dimrit për shkak të kushteve atmosferike dhe për faktin se aktualisht një pjesë e kësaj kohe është ezauruar, shtyrja e afateve të vendimit nr. 140, datë 15.06.2021, me 24 muaj do të mundësonte realizimin e punimeve objekt kontrate dhe për rrjedhojë paisjen e traktit 110 kV me elementet e nevojshëm thikë dhe çelës.
 - Veç sa më sipër me qëllim konsultimin publik të kësaj kërkesë të bërë nga shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k., u realizua publikimi në faqen e internetit të ERE-s, në rubrikën “konsultime” në datën 04.12.2023. Deri më marrjen e këtij vendimi nuk rezulton të jetë dërguar në ERE asnjë opinion apo koment nga palët e interesit për kërkesën e shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k., mbi zgjatjen e afatit të vendimit të bordit të ERE-s, nr. 140, date 15.06.2021.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k., mbi zgjatjen e afatit të vendimit të bordit të ERE-s nr. 140, datë 15.06.2021, si vijon:
 - (i) *Pika 1 gërma (b) e vendimit Nr. 140, datë 15.06.2021, ndryshon si më poshtë vijon:*
“Derogimin/pezullimin e përkohshëm të pikës 3 gërma (b) të nenit 40 të Kodit të Transmetimit miratuar me vendim nr. 63, datë 11.04.2022”.
 - (ii) *Pika 1 gërma (c) e vendimit Nr. 140, datë 15.06.2021, ndryshon behet:*
“Afati i derogimit i përcaktuar në vendimin Nr. 140, datë 15.06.2021, shtyhet për një periudhë 24 muaj deri në 15.06.2025”.
2. Pjesa tjetër e Vendimit nr. 140/2021 mbetet e pa ndryshuar.

3. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Inspektimit, të njoftojë shoqërinë “Kalisi Hydropower” sh.p.k. dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI